

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1të Ligjit për organizimin dhe punën në organet e administratës shtetërore („Gazeta Zyrtare e RM’’ nr. 58/00 dhe 44/02) dhe neni 25 Të Ligjit për arsim fillor („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.103/2008; 33/2010; 116/2010; 156/2010; 18/2011; 42/2011, 51/2011; 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014 dhe 135/2014), ministri i Arsimit dhe Shkencës caktoi Programin mësimor për ***gjeografi për*** klasën e VI (gjashtë) në arsimin fillor nëntëvjeçar.

**Programi
mësimor**



**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

GJEOGRAFIA

KLASA E VI

Shkup, Janar 2015

ARSIMI FILOR NËNTËVJEÇAR

1. HYRJE

Në periudhën e dytë në shkollën fillore, përkatësisht në klasën e gjashtë filloi mësimi i lëndës mësimore për gjeografi.

Programi mësimor i lëndës së *gjeografisë* ndërlidhet me programet mësimore paraprake nga shoqëria.

Duke ndjekur, përkatësisht sistematikën profesionale dhe terminologjinë shkencore, si dhe karakteristikat e nxënësit dhe procesin mësimor , programet mësimore për gjeografi janë menduar ashtu që i zhvillojnë përmbajtjet nga më pak të ndërlikuara deri te më shumë të ndërlikuara (thellësia dhe gjerësia e njohurisë rritet me moshën e nxënësve).

Studimi i gjeografisë si lëndë mësimore në klasën e gjashtë ka për qëllim që nxënësve t'iu mundësojë të përfitojnë njohuri elementare për kozmosin , sistemin Diellor, planetin Tokë, rëndësinë dhe lidhshmërinë e elementeve natyrore, dukuritë shoqërore dhe proceset e sipërfaqes së Tokës. Në klasat e më larta të arsimit nëntëvjeçar në arsimin bazik nxënësit do të njoftohen me kontinentin e: Evropës, Azisë, Afrikës, Amerikën Veriore dhe Jugore, Australinë me Oqeaninë dhe zonat polare.

Lënda mësimore e Gjeografisë mësohet si lëndë mësimore e detyrueshme me 2 orë fond javor (72 orë në vit) në klasën e VI, VII, VIII dhe IX Mësimi nga lënda e gjeografisë duhet të realizohet sipas parimeve vijuese:

- mësimi përqendruar në mësimnxënien e nxënësit;
- nxitje në mësim të pavarur dhe hulumtim të secilit nxënës dhe përmes mësimit të përbashkët në grup;
- respektimi i parimeve të mësimit aktiv;
- ndjekje e vazhdueshme e avancimit të secilit nxënës nga mësimdhënësi dhe dhënia e informatave të rregullta për avancimin;
- vetëvlerësim i avancimit personal të secilit nxënës.

2. QËLLIMET PËR PERIUdhËN ZHVILLUESE PREJ KLASËS VI DERI NË KLASËN E IX

Nxënësi/nxënësjë:

- të aftësohet të njohë ligjshmëritë elementare universale dhe termet e gjeografisë si shkencë;
- të kuptojë lidhshmërinë e gjeografisë me disiplinat mësimore – disiplina shkencore;
- të arrijë parafytyrim dhe të përvetësojë njohuri për objektet, dukuritë dhe proceset përmes shembujve konkret;
- të zbatojë dhe arrijë njohuri për kozmosin, Sistemin Diellor dhe Tokën si planet;
- të kuptojë dhe zbatojë përmasat, teknikat dhe instrumentet për orientimin e hartave fizike dhe ekonomike;
- të zbulojë dhe tregojë fakte për burimet, format, gjendjet dhe ndryshimet në hapësirë;
- të analizojë dhe ndërlidh faktorët natyrorë dhe shoqërorë si elemente për zhvillimin e hapësirës;
- të paraqesë të dhëna numerike në lloj të diagramit, tabelave, skemave dhe të mund t'i interpretojë në mësim;
- të përpunojë dhe propozojë plan për përpunimin e hartave tematike dhe aktivitete hulumtuese;
- të përvetësojë njohuri dhe shkathtësi për zhvillimin e logjikës gjeografike-hapësinore;
- të arrijë njohuri për karakteristikat gjeografike në R. e Maqedonisë;
- të arrijë njohuri për R. e Maqedonisë, si dhe për shtete tjera si bashkësi shoqërore-politike;
- të arrijë njohuri për përfshirjen e botës bimore dhe shtazore në R. e Maqedonisë;
- të arrijë njohuri për karakteristikat gjeografike të kontinenteve, rajonet dhe shtetet në Botë;
- të arrijë njohuri për përfshirjen e botës bimore dhe shtazore në Tokë;
- të arrijë njohuri për popujt dhe shtetet në botë (karakteristikat, ngjashmëritë dhe dallimet);
- të kuptojë parimet kryesore për mbrojtjen e mjedisit jetësor;
- të nxitet për mendim kritik dhe ta kundërshtojë mendimin e vet me mendimin e të tjerëve;
- të nxitet në hulumtime ekzakte të nxënësve për objektet natyrore, proceset dhe dukuritë;
- të tregojë pjesëmarrje aktive në punën e grupit dhe gjatë debateve;
- të aftësohet të shfrytëzojë TIK në mësim për studimin dhe mësimin e gjeografisë.

3. QËLLIMET E MËSIMIT NË KLASËN E VI

Nxënësi/nxënësja:

- të zgjerojë dhe përthellojë kuptimin e ligjeve natyrore dhe koncepteve themelore të natyrës përreth;
- të njohë Sistemi Diellor me planetët e saja dhe satelitët;
- të mund të sqarojë për pozitën e planetit Tokë në sistemin Diellor;
- të mund ti kuptojë lëvizjet tokësore dhe pasojat e tyre;
- të arrijë njohuri për ndërtimin e brendshëm të Tokës, për dukuritë natyrore; tërmetet, vullkanet, stuhitë, uraganet, cuname, për erozionin, fenomenin baticë- zbatimë, të reshurat dhe pasojat nxehja dhe ftohja e tokës, ajrit dhe ujit;
- ta zbulojë krijimin dhe llojet e shkëmbinjve dhe llojet e dheut në Tokë;
- të kuptojë dhe të sqarojë konceptet themelore për llojllojshmërinë e botës së gjallë;
- të zbulojë natyrën dinamike të proceseve dhe fenomeneve natyrore (krijimi i shkëmbinjve, tokave, pasojave për botën e gjallë: adaptimin, shpërndarjen etj.);
- të jep përgjigje të argumentuara, logjiksht të formuluar ndaj pyetjeve/detyrave/problemeve të parashtruara dhe të prezantojë konkluzione, të mbështetura me dëshmi;
- të arrijë njohuri për lëvizjen numerike të popullsisë dhe gjuhët, kulturat, racat e ndryshme në Tokë;
- të mund të lexojë dhe shpjegojë të dhëna nga tabela, grafika, skema, harta gjeografike, globi etj;
- të pranojë dhe realizojë detyra me shkallë të ndryshme të ndërlikimeve gjatë hulumtimit; parashtron pyetje, parashikon, i përdor shqisat, përdor instrumente (thjerrëz, vizore, kompas, hartë dhe glob), shkruan dhe përpunon të dhëna;
- të merr pjesë aktivisht në punën e grupit dhe gjatë diskutimeve;
- të tregojë gatishmëri për rihulumtimin e mendimeve të tyre dhe respekt ndaj mendimit të të tjerëve;
- ta kuptojë rëndësinë e plotësimit të detyrës së dhënë në afatet e parapara.

4. QËLLIMET KONKRETE

Tema I : Kozmosi dhe trupat qiellor (11 orë)			
Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <p>-të njihet me gjeografinë si lëndë mësimore;</p> <p>- të njihet me lëndën e studimit të gjeografisë fizike;</p> <p>-ti dallojë dhe klasifikojë trupat qiellorë në kozmos;</p> <p>-të përshkruajë qiellin dhe yjet;</p> <p>-të merr parafytyrime për hapësirë kozmike;</p> <p>- të sqarojë karakteristikat e Diellit;</p> <p>-të përshkruajë përbërjen e sistemit Diellor;</p> <p>-të përshkruajë karakteristikat e Hënës;</p> <p>-ta kuptojë paraqitjen e menysë së Hënës;</p> <p>-të përshkruajë dukuritë e meteorëve dhe kometave;</p> <p>-të zhvillojë paraqitje personale për vendin e njeriut dhe jetës në kozmos.</p>	<p>-Hyrje për gjeografinë fizike</p> <p>-Kozmosi dhe yjet</p> <p>-Dielli si ylli ynë më i afërt</p> <p>-Planetët dhe satelitët</p> <p>-Hëna dhe menytë e Hënës</p> <p>-Planetoidet, kometat dhe meteorët</p>	<p>- Gjeografia fizike</p> <p>- Gjithësia (kozmosi)</p> <p>-Yjet</p> <p>-Dielli</p> <p>-Sistemi Diellor</p> <p>-Planetët</p> <p>- Satelitët natyrorë</p> <p>-Hëna</p> <p>- Menytë e Hënës</p> <p>-Ekliptika</p> <p>-Planetoidet</p> <p>-Kometat</p> <p>-Meteorët</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënësi sqaron për lëndën e studimit; • TIK prezantime për kozmosin , yjet, planetët dhe trupat tjerë qiellor. (K-stars, Celestija) • Leximi i teksteve për temën. • Përshkrim me pasqyrim për hapësirën pa fund të qiellit. • Vizitë në planetarium dhe bisedë në orë pas vizitës së bërë. • Hulumtim: Vëzhgimi i qiellit me yje. • Përpunimi i panosë për format e ndryshme të Hënës (menytë). • Videoprezantime nga tema. • Bisedë rreth dallimeve të Tokës me trupat tjerë qiellor në kozmos (gjithësi). • Organizimi i bisedës për njeriun dhe kozmosin, për udhëtimin e parë të njeriut në Hënë. • Video paraqitje për trupat qiellor: komete dhe meteorët.

Tema II: Planeti Tokë (12 orë)

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësjja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ta njohë dhe përshkruajë formën e Tokës; - të mund t'i sqarojë dëshmitë për formën e rumbullakët (elipsoide) të Tokës; - të arrijë njohuri se Toka vazhdimisht lëviz; - të dijë se Toka ka fuqi tërheqëse; - të dallojë lëvizjen ditore dhe vjetore të Tokës; - të njohë pasojat nga lëvizja e Tokës; <ul style="list-style-type: none"> - të mund ta caktojë gjerësinë dhe gjatësinë gjeografike; - të njohë kur dhe pse paraqiten ekuinoksi pranveror dhe vjeshtor; - të mësojë për ndryshimet e stinëve vjetore; - të kuptojë lidhshmërinë e revolucionit të Tokës dhe brezat e ngrohtësisë; - të numërojë brezat e ngrohtësisë; - të zbulojë shpërndarjen e botës së gjallë në brezat e nxehtësisë. 	<ul style="list-style-type: none"> -Forma dhe madhësia e Tokës -Rotacioni i Tokës dhe pasojat nga Rotacioni i Tokës -Paralelet dhe meridianet -Gjatësia dhe gjerësia gjeografike -Revolucioni i Tokës dhe pasojat nga revolucionin e Tokës -Brezat e ngrohtësisë 	<ul style="list-style-type: none"> -Forma e rumbullakët -Forma elipsoide -Boshti i Tokës - Polet e Tokës -Rrotullimi -Lëvizja ditore (rotacioni) -Paralelet - Ekuatori - Meridianet - Griniç - Gjerësia gjeografike -Shkalla e paraleleve dhe meridianeve -Gjatësia gjeografike - Lëvizja vjetore (revolucionin) -Ekuinoksi pranveror dhe vjeshtor -Ditë dhe natë polare -Rrethi polar - Brezi i ngrohtësisë 	<ul style="list-style-type: none"> •Përshkrimi i formës Tokësore dhe prezantimi i dëshmimeve. •Leximi i tekstit për mendimet e popujve të vjetër për formën e Tokës. •Mësimdhënësi sqaron konkretizimin e drejtpërdrejtë me ndihmën e globit me rotacionin e Tokës. •Sqaron ndryshimin e ditës dhe natës dhe realizon interaktivitet me nxënësit. •Përpunimi i modelit me rrjet të meridianëve dhe paraleleve. •Ushtrim për përcaktimin e pozitës gjeografike. •Mësimdhënësi sqaron përmes konkretizimit të drejtpërdrejtë për lëvizjet vjetore të Tokës. •Përpunimi i modelit për revolucionin e Tokës me ndihmën e llambës dhe globit. •Video, paraqitje për netët polare. •Ushtrim për ndryshimin e stinëve vjetore (përpunimi i paraqitjes grafike, skemë për jo barabarësinë e ngrohjes së Tokës. •Vizatimi i brezave të ngrohtësisë (përpunimi i panosë).

Tema III: Orientimi i Tokës (8 orë)

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësj:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të mund pavarësisht ti përcaktojë anët e botës në hartën e botës dhe në natyrë; - të sqarojë për shpërndarjen dhe numrat orëve të zonave të Tokës me glob dhe hartë; - të mund ta shfrytëzojë termin kohë lokale; - ta kuptojë rëndësinë e termit madhësi dhe zbatimi i tij në hartë; - të mund ta përdorë globin si mjet i konkretizuar për prezantimin e Tokës; - ti njohë llojet e ndryshme të hartave; - ti njohë njësitë për shprehjen e gjerësisë gjeografike (ekuator) dhe gjatësisë gjeografike (griniç); - ti gjejë dhe ti tregojë toponimet gjeografike në hartë; - përmes shembujve me ndihmën e ngjyrave dhe izohipseve ta sqarojë prezantimin e relievit në hartë. 	<ul style="list-style-type: none"> -Kalendari, zonat kohore dhe koha lokale -Madhësia -Toka në glob dhe në hartë gjeografike -Paraqitja e relievit në hartë 	<ul style="list-style-type: none"> -Kalendari -Zonat kohore -Koha lokale -Kufiri sipas datës -Shkallë numerike -Madhësia, shkalla grafike -Masa kryesore -Shenjat topografike -Globi -Globi induktiv -Atlasi -Busull -Izohipset -Kote -Relievi 	<ul style="list-style-type: none"> •Mësimdhënësi sqaron për shkaqet për dukurinë e kalendarit të parë. •Bisedë interaktive me nxënësit për dukurinë e zonave lokale (cila është zona lokale fillestare). •Bisedë me nxënësit për përcaktimin e kohës lokale; • Ushtrim në klasë ose oborr shkolle për përcaktimin e anëve të botës me ndihmën e kompasit. •Orientimi në natyrë: me ndihmën e qëndrimit të trupit, pozitës së Diellit, myshkut të drurit, hijes të ndonjë objekti etj. • Prezantimi i objekteve natyrore në hartë, në madhësi të dhënë. •Planifikimi i udhëtimit të imagjinuar përmes zonave të ndryshme kohore. •Përpunimi i përmbledhjes të llojeve të ndryshme të dheut.

Tema IV: Mbështjellësi i ngurtë i Tokës (litosfera) (11 orë)

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësj:</p> <p>Të din ti dallojë sferat në brendinë e Tokës;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të njihet me karakteristikat themelore të sferave; - ta sqarojë krijimin e forcave të brendshme dhe ndikimin e tyre për krijimin e formave të ndryshme të relievit; - ta sqarojë krijimin e forcave të jashtme dhe ndikimin e tyre për formimin e formave të ndryshme të relievit; - të dijë për ndikimin e përbashkët të forcave të brendshme dhe të jashtme; - të din të sqarojë për krijimin e llojeve të ndryshme të shkëmbinjve të Tokës; - të aftësohet në mënyrë të pavarur ta dalloj dhe sqaroj radhitjen e tokës; - të aftësohet të sqarojë për krijimin dhe shfrytëzimin e tokave. 	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi i brendshëm i Tokës Format e relievit të krijuara nën veprim të forcave të brendshme Format e relievit të krijuara nën veprimin e forcave të jashtme Formimi i shkëmbinjve dhe llojet e shkëmbinjve Renditja e pjesës tokësore të Tokës Llojet e tokës 	<ul style="list-style-type: none"> - Litosfera - Bërthama tokësore - Mbështjellësi tokësor <ul style="list-style-type: none"> - Malet vargore - Malet gromade - Fushëgropat - Luginat - Magma - Vullkanet - Krateri vullkanik - Kupa Vullkanike - Tërmetet - Hipoqendra - Epiqendra - Cunami - Kanjoni - Akullnaja (gleçer) - Shkretëtirat me rërë] - Oazat - Shkëmbinj të sedimentues 	<p>Mësimdhënësi në mënyrë interaktive i njeh nxënësit me ndërtimin e brendshëm të Tokës.</p> <p>Përpunimi i modelit për sferat Tokësore.</p> <p>TIK prezantimet për paraqitjen e formave të reja të relievit nën ndikimin e forcave të brendshme.</p> <p>-Paraqitja apo përpunimi i maketeve për format e relievit.</p> <p>- Biseda për formimin dhe krijimin e formave të relievit nën ndikim të forcave të jashtme (temperatura, era, uji i detit dhe lumit, akulli etj.)</p> <p>Pasqyra apo TIK të gropave dhe shpellave.</p> <p>Demonstrimi i hartës për vendosjen e tokës dhe ujit në Tokë</p> <p>-Paraqitja e përmbledhjeve të llojeve të ndryshme të tokave.</p>

		<ul style="list-style-type: none"> - Shkëmbinjtë magmatik - Shkëmbinjtë metamorf 	
--	--	--	--

Tema V: Mbështjellësi ujour i Tokës (hidrosfera) (7 orë)			
Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të din ta njeh dhe sqarojë nocionin Deti Botëror; - ta din përbërjen e Detit Botëror; - të din të sqarojë vetitë e ujit të detit; - ti dallon faktorët të cilët drejtpërdrejtë ndikojnë për lëvizjet e ujit të detit; - ta përshkruajë krijimin e dukurisë së ujërave nëntokësor; - të aftësohet të sqarojë për paraqitjen e vellos, gejzerëve dhe pusi arterial; - të aftësohet ti sqarojë elementet te lumenjtë dhe liqenet. 	<ul style="list-style-type: none"> - Deti Botëror - Vetitë e ujit të detit - Ujërat nëntokësor dhe burimet - Lumenjtë dhe liqenet - 	<ul style="list-style-type: none"> - Hidrosfera - Deti botëror - Valët - Rrymat detare - Batica dhe zbatica - Vrella - Pusët arteriale - Gejzerë - Meandra - Grykë mali; - Kanjone - Ade - Liqene tektonike - Liqene akullnajore - Liqene (gëlqerore) karstike 	<ul style="list-style-type: none"> •Diskutimi me nxënësit dhe shfrytëzimi i hartës së Botës për vendosjen dhe madhësinë e Detit Botëror. - Të shikuarit e ilustrimeve prej pjesëve të oqeanëve dhe deteve. - TIK prezantimi për vetitë e ujit të detit (valët, batica dhe zbatica) - Mësimdhënësi sqaron për ndikimin e ujit të detit në ndryshimin e vijës bregdetare (bregdeti pjerrët dhe plazhi). - Si vjen në ujin arterial (pusët arteriale në Australi) - Pasqyra e burimeve, izdan dhe gejzer. - TIK prezantimi për kanjonin Kolorado, grykat e Lumit Vardar dhe meandrat e

			<p>Amazonit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pasqyra e ishullit të lumit (Ada Ciganlija – Beograd). - Përshkrimi për krijimin e liqeneve të mëdha tektonike (Liqeni i Ohrit). - Leximi i pasqyrave të papunuara për Liqenin Kaspik (i njelmët) dhe Liqeni i Bajkallit (liqeni më i thellë me ujë të ëmbël në Tokë).
--	--	--	---

Tema VI: Mbështjellësi ajror i Tokës (atmosfera) (14 orë)

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të din të sqarojë për përbërjen, ndarjen dhe rëndësinë e mbështjellësit ajror; - të din ta përshkruaj nxehjen e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të atmosferës; - të njeh për nxehje e ndryshme të ajrit mbi sipërfaqen e Tokës; - të din ta sqarojë nocionin shtypja e ajrit; - të aftësohet të sqarojë kur ka 	<ul style="list-style-type: none"> - Përbërja dhe ndarja e atmosferës -Nxehja e atmosferës -Shtypja ajrore -Lëvizja e ajrit 	<ul style="list-style-type: none"> - Atmosfera - Troposfera - Stratosfera - Jonosfera - Ekzosfera - Temperatura e ajrit - Shtypja (atmosfera e ajrit - Hektopaskale - Erë 	<ul style="list-style-type: none"> •Mësimdhënësi sqaron për rëndësinë e atmosferës mbi jetën dhe pamja e planetit Tokë. TIK prezantimi për dukuritë në atmosferë. Përpunimi i panoave si formë në grupet e punës për ndarjen e atmosferës në sfera. Ushtrimi, matja e temperaturës së ajrit me termometër. Biseda interaktive për paraqitjen e shtypjes së ndryshme ajrore.

<p>shtypje të ulët dhe kur ka shtypje të lartë të ajrit mbi sipërfaqen e Tokës;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të din të diskutojë për paraqitjen e erës dhe karakteristikave të saj; - të sqarojë për lagështinë e ajrit dhe llojeve të reshjeve të ndryshme; - të din ti sqarojë nocionet kohë dhe klimë; - të aftësohet ta përshkruaj shpërndarjen territoriale dhe karakteristikat kryesore të llojeve klimatike të Tokës. 	<p>-Lagështia e ajrit dhe reshjet</p> <p>-Koha dhe klima</p> <p>-Llojet klimatike</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Mjegulla - Retë - Koha - Klima - Faktorët klimatik - Llojet klimatike 	<p>TIK paraqitja për dukurinë e tornados, uraganit, tajfunit dhe harikenit.</p> <p>Përpunimi i pasqyrës për karakteristikat e elementeve klimatike.</p> <p>Vizita e stacionit më të afërt meteorolog.</p> <p>Përpunimi i esesë së shkurtër për kohën dhe klimën në vendlindjen e vetë.</p>
--	---	--	--

Tema VII:Sfera e botës organike (biosfera) (ora e 9)

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ta njeh vendosjen gjeografike të botës bimore; - të din të sqarojë se si faktorët natyror ndikojnë drejtpërdrejtë në shpërndarjen gjeografike të shpërndarjes territoriale të florës; - të din ta përshkruajë shpërndarjen territoriale të botës shtazore; - ta sqarojë lëvizjen numerike të botës shtazore; - të din ta përshkruaj dendësinë e popullsisë sipas rajoneve dhe kontinenteve; 	<ul style="list-style-type: none"> - Vendosja gjeografike e botës bimore - Shpërndarja gjeografike e botës shtazore -Popullsia e Tokës 	<ul style="list-style-type: none"> -Biosfera -Flora -Fauna -Bashkësia bimore -Ekuatorit Pyje me të reshura -Parapyje -Xhungla -Makije -Tajga -Savane -Lanose dhe kampose -Stepe 	<ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënësi u sqaron nxënësve për faktorët natyror prej të cilëve varet vendosja e llojeve të bimëve të caktuara. TIK prezantimet për pyjet me të reshura (Amazon) Leximi i teksteve për temën. Përshkrimi me pasqyrë për vendosjen territoriale të botës bimore. Vizita e muzeut natyrorë shkencor dhe kopshti zoologjik. Hulumtimi për vendosjen e

<ul style="list-style-type: none"> - të aftësohet të diskutojë për rritjen e ndryshme të popullsisë; - ti njeh racat themelore dhe të përziera në botë; - të sqarojë për kulturat e ndryshme dhe karakteristikat e tyre; - të din ti numërojë dhe përshkruajë religjionet e ndryshme në botë. 	<p>Raca, kultura dhe religjioni</p>	<ul style="list-style-type: none"> -Preria -Pampase -Suvate -Tundra -Shkretëtirat -Lëvizja numerike -Racat -Kulturat -Religjionet 	<p>popullsisë në Tokë. Përpunimi i panove për dendësinë e popullsisë. Videoprezantime nga hapësira e populluar rrallë dhe dendur. Sqarimi i mësimdhënësit për racat dhe popullsinë e përzier. Organizimi i bisedës dhe prezantimi për kulturat e ndryshme dhe religjionet. TIK pasqyrimi për kulturat dhe religjionet e ndryshme.</p>
---	-------------------------------------	--	---

5. REKOMANDIMET DIDAKTIKE

Në programin mësimor është dhënë planifikimi orientues në orët mësimore për realizimin e temave dhe tërësive mësimore. Megjithatë kuadri mësimor duhet në mënyrë të pavarur ta planifikojë fondin e orëve për realizimin e tërësishëm dhe të suksesshëm të qëllimeve të parashtruara. Duke e pasur parasysh atë se përbërja e nxënësve në paralele është heterogjen, mësimdhënësi duhet të praktikojë qasje diferenciale dhe individuale në kuadër të realizimit të mësimin. Qasja e tillë është në funksion të nevojave individuale specifike të secilit nxënës dhe zhvillimi i potencialeve individuale dhe të arriturave.

Rekomandohet përdorimi i mjeteve vijuese:

- libër i zgjedhur në nivel të shkollës për lëndën adekuate, lejuar nga ana e ministrit;
- burimet tjera të mësimin në mjedisin e drejtpërdrejtë – objekte dhe dukuritë në natyrë;
- enciklopedia, atlasit etj;
- interneti, softueri arsimor;
- revista;
- mjetet audio vizuale.

Teknologjia didaktike bashkëkohore në mësimin e gjeografisë përveç shfrytëzimit të hartave të ndryshme gjeografike, jep mundësi të veçanta për përdorimin e kompjuterit, përkatësisht zbatimin e gjerë të gjeoinformatikës në mësimin e gjeografisë. Gjithashtu në mësim mund të përdoren dhe harta memece, libër të gjeografisë, doracak për mësimin et.

Nocionet e përvetësuara të reja do të prezantojnë sendërtimin dhe përhapjen e disa nocioneve të arritura. Interpretimi dhe përshkrimet nga ana e nxënësve është i domosdoshëm që të jenë të nxitur nga mësimdhënësi në mënyrën e cila përshtatet në karakteristikat individuale të nxënësit. Të shprehurit mund të jetë përmes: të folurit, esesë, metodat ilustrative, përpunimi i skemave, grafikonet etj. Përdorimi i emrave dhe të dhënat në shifra duhet të reduktohet në nivel logjik.

Integrimi i gjeografisë me lëndët tjera mësimore do të realizohet në të gjithë situatat në të cilat është prezent lidhshmëria më e madhe e përmbajtjeve.

6. VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE

Rekomandohet të përdoren mënyrat vijuese për përcjelljen, kontrollimin dhe vlerësimin e të arriturat e nxënësve në kuadër të temave mësimore.

- gojarisht;
- me shkrim;
- në praktikë (përpyetje, ushtrime dhe ngjyshëm);
- pjesëmarrje në hulumtim dhe prezantim.

Nxënësit vlerësohen me notë përshkruese gjatë vitit dhe notë numerike vetëm në gjysmëvjetor dhe në fund të vitit shkollor.

7. KUSHTET HAPËSINORE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

Sa i përket kushteve hapësinore Programi bazohet në Normativin për hapësirë, pajisje dhe mjetet mësimore për arsimin fillor nëntëvjeçar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës me vendim nr. 07-1830/1 prej 28.02.2008.

8. **NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR**

Mësimin në gjeografi për klasën e VI (e gjashtë) mund ta realizojë personi i cili ka mbaruar:

- Studimet për gjeografi, drejtimi mësimor, 7/1;

Nënshkrimi dhe data e caktimit të Programit mësimor

Programi mësimor për gjeografi për klasën e VI (gjashtë) për arsimin fillor nëntëvjeçar me propozim të Byrosë së zhvillimit të arsimit, e caktoi

Ministër

Abdilaqim Ademi

РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА
Бр. 12-2165/1 од 09.02.2015 година
Скопје

Përpiloi: Ivica Gievski, udhëheqës njësie, koordinator

Kontrolloi: Trajçe Gjorgjievski, udhëheqës njësie

Lejoi: mr.Mitko Çeshllarov, udhëheqës sektori